



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V_350_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK_V_523_02_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_523_02_11**;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 14.03.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Reshat Kreka (shifra e konsumatorit DPZ – 7797) nga Prizreni, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 28.04.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 26.04.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 30.08.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 7796317 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 44143937.
Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0241/B, i datës 30.08.2007
- Me datë 31.10.2007 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 7796317 ku është konstatuar se njehsori elektrik bllobat (vulat) shtetërore i ka në rregull, qelqi është i hequr nga vendi, kufizuesi i qelqit nga ana e jashtme është i prerë, për rreth kufizuesit të qelqit është futur pjesë metali dhe është penguar puna e diskut, si dhe në brendi të njehsorit ka pjesë të metalit dhe disku është i gërvishtur.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 25/31 i datës 31.10.2007
- Me datë 01.02.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit ku kanë konstatuar gjendjen teknike të njehsorit elektrik.
Provë: Procesverbali i KEK-ut, nr. 038211 i datës 01.02.2008
- Me datë 15.02.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ08HP04094 në vlerë prej 3,132.74€.
Provë: Fatura DPZ08HP04094 datës 15.02.2008



- Me datë 12.03.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK i datës 12.03.2008
- Me datë 26.04.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e inspektimit dhe kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 26.04.2010
- Me datë 28.04.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së, datë 28.04.2010
- Me datë 14.02.2011, DMK ka lëshuar vendimin nr. ZRRE/DMK_V_ 523_02_11 dhe duke u bazuar në analizat e bëra ka vendosur që të refuzojë pjesërisht dhe ka arritur në përfundim se:
 1. KEK-u duhet ta shkarkoj shifrën DPZ – 7797 nga fatura e rikthimit të humbjeve DPZ08HP04094 në vlerë prej 3,132.74 €, të datës 15.02.2008.
 2. Pasi që KEK-u nuk ka zbatuar procedurën në fuqi për llogaritjen e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë në periudhën në atë kohë (Gazeta Zyrtare e KSAK 1982), obligohet të dal te konsumatori për ta bërë regjistrimin e të gjitha pajisjeve që posedon konsumatori dhe sipas pajisjeve të bëjë llogaritjen e faturës së rikthimit të humbjeve.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_ 523_02_11 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: ZRRE/DMK_V_ 523_02_11 të mbetet në fuqi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar